

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-139/14**

Prishtinë, 18 maj 2016

Në çështjen juridike të:

**S.D.**

Fshati Jasenovik

Novobërdë

Kosovë

**Pala ankuese**

Kundër

**Z.S.**

Svetogorska 1147

34000 Aerodrom

Republika e Serbisë

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/221/2013 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA36438) të datës 27 Nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 18 maj 2016, mori këtë:

**AKTGJYKIM:**

1. **Refuzohet si e pabazuar ankesa e S.D. e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/221/2013 të datës 27 Nëntor 2013.**
2. **Konfirmohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/221/2013 të datës 27 Nëntor 2013 për sa i përket lendes se regjistruar ne AKP me numër KPA36438.**

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 5 Korrik 2007 Z,S. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë), në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronave (më tej AKP) me të cilën kërkonte riposelimin mbi një shtëpi banimi dhe rrethinave me një sipërfaqe prej 193 m<sup>2</sup> (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar) të ndërtuar në ngastrën kadastrale nr.1202 që ndodhet në fshatin Jasenovik në komunën e Novobërdës. Në kërkesë ajo ka theksuar se është pronare e 1/3 pjese ideale të ngastrës mbi të cilën është ndërtuar shtëpia. Gjithashtu ajo ka deklaruar se shtëpia është uzurpuar nga persona të panjohur dhe se posedimi mbi pronën ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur në periudhën 1998/99, duke përmendur 12 Qershorin 1999 si datën e humbjes. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA36438.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar këto dokumente:
  - Fletën Poseduese nr.27, date 18 tetor 2005, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi. Në fletën poseduese, prona e kërkuar është regjistruar në emër të S.D. , babait i palës përgjegjëse në ankesë.
  - Aktvendimi i trashëgimisë T.nr.249/89 date 10 Janar 1990 i lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, që dëshmon se pala përgjegjëse në ankesë është trashëgimtare në pjesën 1/3 të pasurisë së babait të saj, përfshirë dhe pronën e kërkuar. Sipas raportit të verifikimit të datës 7 Shkurt

2011, ky aktvendim është gjetur ne arkivën e gjykatës komunale ne Prishtine, por rezulton se nuk është bere i plotfuqishëm.

3. Dokumentet e mësipërme janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.
4. Prona është verifikuar fizikisht më 8 Janar 2008. Nga verifikimi u gjet se prona e kërkuar është një shtëpi me oborr e uzurpuar nga L.D. , e cila ishte e pranishme gjate verifikimit.
5. Kërkesa është kontestuar nga S.D. (ne tekstin e mëtejme: pala ankuese) i cili me date 8 Janar 2008, nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes dhe deklaroi se është duke e shfrytëzuar pronën e kërkuar për qëllime banimi dhe pretendoi të drejtë ligjore mbi të. Ai u paraqit në AKP më 8 Janar 2008, si palë përgjegjëse në kërkesë. Për t'i mbështetur pretendimet e veta, pala ankuese dorëzoi një deklaratë me anë të së cilës deklaronte se ai është duke e përdorur pronën e kërkuar qe është njëkohësisht dhe shtëpia e gjyshit të tij prej vitit 2000 dhe se çelësat e saj i ka marre prej hallës së tij, J.D. . Në deklaratën e tij ai pretendon se pala përgjegjëse në ankese e ka fituar pronën ne mënyrë joligjore, duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë nga procedura e trashëgimisë. Në mbështetje të deklaratës se tij ai shtoi se ka paraqitur një padi kundër kushërinjve të tij/bashkëpronarëve në gjykatën komunale në Prishtinë për konfirmimin e se drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar.
6. Ne shkresat e lëndes u gjet se Sekretariati Ekzekutiv ex-officio ka bërë verifikimet përkatëse dhe se ka gjetur që padia e palës ankuese e paraqitur ne gjykatën komunale në Prishtine ne vitin 2008, është hedhur poshtë me vendim të kësaj gjykate. Përveç kësaj pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë dokument tjetër për te mbështetur pretendimet e tij.
7. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), bazuar në provat e dorëzuara nga palët, me Vendimin KPCC/D/R/221/2013, të datës 27 Nëntor 2013, vendosi që ta pranojë kërkesën e Z.S. dhe ka vendosur qe ajo është pronare mbi 1/3 e pronës se kërkuar.
8. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 21 Shkurt 2014. Pala përgjegjëse ne ankese mori dijeni për vendimin e KKPK-se me date 3 Prill 2014.

9. Më 17 Mars 2014, pala ankuese, dorëzoi një ankesë në Gjykatën Supreme duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së. Së bashku me ankesën, pala ankuese paraqiti padinë nr.2614, date 16 Tetor 2008 te dorëzuar ne Gjykatën Komunale ne Prishtine, dega Graçanicë dhe ankesën nr.023570, date 28 Qershor 2010 kundër vendimit te Gjykatës Komunale ne Prishtine drejtuar Gjykatës se Qarkut Prishtine.

### **Pretendimet e palës ankuese**

10. Pala ankuese, S.D. , në ankesën e vet ka deklaruar se vendimi i ankimuar përmbante shkelje esenciale, zbatim të gabuar të ligjit material dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke theksuar se Komisioni ne marrjen e vendimit ankimor nuk ka marre ne konsideratë padinë e dorëzuar para Gjykatës Komunale në Prishtinë. Në këtë kërkesë, pala ankuese ka sqaruar se mes tjerash, prona e kërkuar ka qenë pronë e të ndjerit S.D., gjyshi i tij dhe se nuk ishte kryer procedura e trashëgimisë pas vdekjes së tij. Ai shtoi se prona e kërkuar ishte regjistruar në mënyrë të kundërligjshme dhe sekrete në emër të xhaxhait te tij, S.D. dhe se pas vdekjes se tij kjo prone është trashëguar nga gruaja e tij J.D. si dhe dy vajzat e Z.S. dhe S.K.. Ai deklaroi se është duke e përdorur pronën e kërkuar qe është njëkohësisht dhe shtëpia e gjyshit te tij prej vitit 2000 dhe se çelësat e saj i ka marre prej hallës se tij, J.D. . Lidhur me pretendimet e palës përgjegjëse ne ankese se ka humbur posedimin mbi pronën e kërkuar si rrjedhoje e rrethanave te krijuara nga konflikti i armatosur ne vitet 1998-1999, pala ankuese sqaron se kjo deklarate nuk është e vërtetë, pasi pala përgjegjëse ne ankese jeton prej 30 vitesh ne Kragujevac dhe se prona e kërkuar nuk ka qene ne shfrytëzim prej viteve 1977-1978.

### **Arsyetim ligjor**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

11. Ankesa kundër vendimit te KKPK-se nr KPCC/D/R/221/2013 është dorëzuar brenda 30 ditëve nga momenti qe AKP i ka dorëzuar vendimin palës ankuese, ashtu siç parashikohet ne Seksionin 12.1 te Rregullores se UNMIK 2006/50 Mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-79(këtu e me tej: Rregullore e UNMIK 2006/50) është e pranueshme.

12. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve rezulton se midis palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankese ekziston një konflikt pronësie.
13. Pala përgjegjëse ne ankese pretendon pronësinë mbi pronën e kërkuar bazuar në aktvendimin e trashëgimisë T.nr.249/89 date 10 Janar 1990 i lëshuar nga Gjykata Komunale ne Prishtine. Ne anën tjetër, pala ankuese, njëkohësisht dhe djali i xhaxhait te palës përgjegjëse ne ankese e konteston këtë vendim si te paligjshëm. Nga ana e ekipit te verifikimit te AKP-se është gjetur se vendimi i sipërpërmendur nuk është bere i plotfuqishëm dhe se kundër tij është paraqitur një padi ne gjykatën komunale ne Prishtine dhe me pas një ankese ne Gjykatën e Qarkut ne Prishtine.
14. Nga deklaratat e palëve duket se mosmarrëveshja në mes të anëtarëve të së njëjtës familje është e hershme dhe se origjina e saj nuk ka asgjë të përbashkët me konfliktin e armatosur, i cili ka ndodhur në mes të 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999. Fakti që pala përgjegjëse ne ankese ka braktisur Kosovën më datën 12 Qershor 1999 nënkupton se uzurpimi i ngastrës së saj nga ana e kushëririt lidhet me këtë konflikt të armatosur dhe qasja në pronë e palës përgjegjëse në ankesë është pamundesuar.
15. Pretendimi e palës ankuese se pala përgjegjëse nuk e ka shrytëzuar pronën as para konfliktit të armatosur nuk e vë në pyetje të drejtën pronësore të palës përgjegjëse dhe nuk e legjitimon uzurpimin e pronës menjëherë pas konfliktit.
16. Nga të gjitha këto që u thanë më lart, Gjykata Supreme konstaton se pala ankuese nuk ka arritur të dëshmoi ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e as të paraqesë prova se KKPK-ja ka nxjerr vendim në shkeljeje te dispozitave procedurale ose te ligjit material.
17. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja e ka bazuar vendimin ne përcaktimin korrekt dhe te plote te gjendjes faktike dhe ne aplikimin e duhur te ligjit material. Prandaj, Gjykata Supreme arrin ne përfundimin se ankesa është e pabazuar.
18. Në bazë të arsyeve të lartpërmendura në pajtim me nenin 13.3.c te Rregullores se UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 198 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, vërtetohet vendimi i KKPK-së dhe refuzohet ankesa.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

*Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit*

*Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it*

*Beshir Islami, Gjyqtar*

*Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it*